



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 25.03.2024

Nr. 662/2 prot:

VENDIM

Nr 12 date 18.03.2024

DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI I PUKËS” (PAS VDEKJES)

Z. Ndue Dashi (Ndou)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, germa “m”, ligjit 112/2013 “ Për dekoratat, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Z. Rrok Dodaj, si dhe miratimit të Komitetit Keshillimor për Dhëniën e Titujve Vendor të Nderit, Keshilli i Bashkisë Pukë, pasi u njoh me propozimin e Kryetarit të Bashkisë dhe me dokumentacionin e paraqitur:

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “Qytetar Nderi i Pukës” për: **Z. Ndue Dashi (Ndou)**

Me motivacionin:

“Për qëndresën dhe kontributin e dhënë gjatë kryengritjes së malësorëve pukjanë kundër pushtuesve turq në vitin 1911-1912, në mbrojtjen e interesave ekonomike dhe politike të malësorëve pukjan, si dhe në mbrojtje të lirisë dhe pluralizmit gjatë viteve 1924-1926”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.
4. Miratuar me 11 vota Pro , 0 Abstenim , 0 Kunder
5. Shpallur me date **25.03.2024**

SEKRETARE

Edona **HYSENAJ**

KRYETARI KESHILLIT

Eduard **GJOKA**

